



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 95 /2011

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.08.2011 merr këtë:

**VENDIM  
PËR  
RIDESTINIM TË MJETEVE FINANCIARE**

**I**  
Kuvendi i Komunës miratoi propozim vendimin me numër 01/Nr.95/2011 për ridestitim të mjeteve financiare nga kategoria ekonomike shpenzime kapitale.

**II**  
Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të Komunës dhe anëtarëve të Kuvendit të Komunës për zgjerim të listës së projekteve kapitale për vitin 2011 që janë në interes të Komunës.

**III**  
Duke iu referuar nenit I të këtij vendimi projektet që do të ridestinoen janë nga programi (660) Planifikim Urban dhe mjedis, nën-programi (66480) planifikimi urban dhe inspeksioni kemi këto ridestinime brenda programit planifikimi urban dhe mjedisit nga grandit qeveritar fondi 10.

Nga projekti "Rregullimi i rrugës Dheu i Bardhë – Paldenicë" kodi (83390) shuma prej 10.000 € të ridestinohet në projektin "Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit – Dimcë" kodi (83386) në shumën prej 10.000 €.

Nga projekti "Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit - Varrezat e Dëshmoreve" kodi (83387) shuma prej 5.000 € të ridestinohet në projektin "Rindërtimi i objekteve të rrënuara përgjatë rrugës Hani i Elezit - Gorancë" projekt i ri në shumën prej 5.000 €.

Nga projekti "Instalimi i stacionit për monitorim të përhershëm të ndotjes së ajrit" kodi (83388) shuma prej 3.000 € të ridestinohet në projektin "Rindërtimi i objekteve të rrënuara përgjatë rrugës Hani i Elezit - Gorancë" projekt i ri në shumën prej 3.000 €.

Nga projekti "Rregullimi i sipërfaqes së tregut të gjelbër" kodi (83391) shuma prej 6.000 € të ridestinohet në projektin "Rregullimi i rrugës nga varrezat deri te Lagja e re" kodi (83394) në shumën prej 6.000 €.

Nga projekti "Rregullimi i rrugës nga Ura e Fezës - Rrafshe – Meliq" kodi (83393) shuma prej 10.000 € të ridestinohet në projektin "Rregullimi i rrugës nga varrezat deri te Lagja e re" kodi (83394) në shumën prej 10.000 €.



Nga projekti "Aneksi i QKMF-së në Han të Elezit " kodi (83398) shuma prej 7.000 € të ridestinohet në projektin "Rregullimi i rrugës nga varrezat deri te Lagja e re" kodi (83394) në shumën prej 7.000 €.

Nga projekti "Autoambulancë për nevojë të QKMF-se në Han të Elezit" kodi (83399) shuma prej 6.000 € të ridestinohet në projektin "Rregullimi i rrugicave në disa pjese te qytetit" kodi ( 83396) në shumën prej 6.000 €.

Nga projekti "Ndërtimi i objektit të Qendrës për Punë Sociale" kodi (83400) shuma prej 10.000€ të ridestinohet në projektin "Dislokimi i trafos së qytetit" kodi (83552) ne shumën prej 10.000 €.

Nga projekti "Punimi i nxehjes së shkollës fillore "Kështjella e Diturisë" në Paldenicë" kodi (83389) shuma prej 11,866.49 € të ridestinohet në projektin "Asfaltimi i lagjes në Kallamoqe" projekt i ri në shumën prej 11,866.49 €.

Nga projekti "Renovimi i kulmit të shkollës fillore "Ilaz Thaqi" në Han të Elezit" kodi (83402) shuma prej 3,005.50 € të ridestinohet në projektin "Asfaltimi i lagjes në Kallamoqe" projekt i ri në shumën prej 3,005.50€.

Nga projekti "Renovimi i kulmit të shkollës fillore "Ilaz Thaqi" në Han të Elezit" kodi (83402) shuma prej 10.000 € të ridestinohet në projektin "Mjete të lira për Bashkëinvestime" kodi (83409) në shumën prej 10.000 €.

Nga projekti "Rihapja e rrugës Paldenicë – Neqafc" kodi (83403) shuma prej 5.000 € të ridestinohet në projektin "Kanalizimi i një pjese te Hanit te Elezit" kodi (83553) në shumën prej 5.000 €.

Nga projekti "Fond për trajnime të ndryshme" kodi (83405) shuma prej 3.500€ të ridestinohet në projektin "Kanalizimi i një pjese të Hanit të Elezit" kodi (83553) në shumën prej 3.500 €.

Nga projekti "Furnizim me transformator të rrymës elektrike në lagjen Kallamoqe" kodi (83406) shuma prej 3.000 € të ridestinohet në projektin "Kanalizimi i një pjese të Hanit të Elezit" kodi (83553) në shumën prej 3.000 €.

Nga projekti "Rregullimi i Tensionit të larte të rrymës nga rruga e Gorancës deri te ish Repetitori i TVP-se" kodi (83392) shuma prej 1.500 € të ridestinohet në projektin "Kanalizimi nga fshati Meliq - lagja e re " – projekt i ri në shumën prej 1.500 €.

Nga projekti "Rregullimi i kanalizimit nga Uji i Thartë - Hani i Elezit" kodi (83404) shuma prej 18.000 € të ridestinohet në projektin "Kanalizimi nga fshati Meliq - lagja e re " – projekt i ri në shumën prej 18.000€.

Nga projekti "Rregullimi i rrugicës nga Lagja Ballazh – Meliq" kodi (83395) shuma prej 16.000€ të ridestinohet në projektin "Blerja e një kamioni për bartje të mbeturinave" projekt i ri në shumën prej 16.000 €.

Nga projekti "Vendosja e policëve të shtrirë nëpër rrugët kryesore të Hanit të Elezit" kodi (83397) shuma prej 2.434 € të ridestinohet në projektin "Blerja e një kamioni për bartje të mbeturinave" në shumën prej 2.434€.

Nga projekti "Rregullimi i rrugës dhe kanalizimi nga rruga e të Përndjekurve - Ura e Fezës" kodi (83407) shuma prej 11.320 € të ridestinohet në projektin "Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ujësjellësit" - projekt i ri në shumën prej 11.320 €



Nga programi 920 Arsimi dhe shkenca, nën-programi (92175) Administrata e arsimit kemi këtë ridestitim : nga projekti "Renovimi i kulmit të shkollës së mesme „Dardania” në Han të Elezit” kodi (83410) shuma prej 6000 € të ridestinohet në projektin "Riparimi i nyjeve sanitare nëpër shkolla" – projekt i ri në shumën prej 6.000€. Nga projekti "Ndërimi i dysHEMEVE të klasëve të shkollës fillore" Ilaz Thaqi" në Han të Elezit" kodi (83411) shuma prej 3,710.13€ të ridestinohet në projektin "Riparimi i nyjeve sanitare nëpër shkolla" – projekt i ri në shumën prej 3,710.13 € në të njëjtin program.

**Ridestnimi i projekteve kapitale brenda programit Planifikim urban dhe mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480) nga të hyrat vetanake fondi 21.** Nga projekti "Rregullimi i rrugës Dheu i Bardhe – Paldenicë" kodi (83390) shuma prej 5.000 € të ridestinohet në projektin "Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit – Dimcë" kodi (83386) në shumën prej 5.000 €.

Nga projekti "Rregullimi i sipërfaqes së tregut të gjelbër" kodi (83391) shuma prej 4.000€ të ridestinohet në projektin "Rregullimi i rrugës nga varrezat deri te Lagja e re" kodi (83394) në shumën prej 4.000 €.

Nga projekti "Rregullimi i rrugës nga Ura e Fezës - Rrafshe – Meliq" kodi (83393) shuma prej 10.000 € të ridestinohet në projektin "Rregullimi i rrugës nga varrezat deri te Lagja e re" kodi (83394) në shumën prej 10.000 €.

Nga projekti "Aneksi i QKMF-së në Han të Elezit " kodi (83398) shuma prej 3.000 € të ridestinohet në projektin "Rregullimi i rrugës nga varrezat deri te Lagja e re" kodi (83394) në shumën prej 3.000 €.

Nga projekti "Autoambulancë për nevoja të QKMF-së në Han të Elezit" shuma prej 4.000 € të ridestinohet në projektin "Rregullimi i rrugicave në disa pjesë të qytetit" kodi (83396) në shumën prej 4.000 €.

Nga projekti "Instalimi i stacionit për monitorim të përhershëm të ndotjes së ajrit" kodi (83388) shuma prej 2.700 € të ridestinohet në projektin "Fond për shpronësim" kodi (81430) në shumën prej 2.700 €.

Nga projekti "Renovimi i kulmit të shkollës fillore "Ilaz Thaqi" në Han të Elezit" kodi (83402) shuma prej 4.000 € të ridestinohet në projektin "Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ujësjellësit" - projekt i ri në shumën prej 4.000 €.

Nga projekti "Renovimi i kulmit të shkollës fillore "Ilaz Thaqi" në Han të Elezit" kodi (83402) shuma prej 3.000 € të ridestinohet në projektin "Rindërtimi i objekteve të rrënuara përgjatë rrugës Hani i Elezit - Gorancë" projekt i ri në shumën prej 3.000€.

Nga projekti "Rihapja e rrugës Paldenicë – Neqafç" kodi (83403) shuma prej 5.000€ të ridestinohet në projektin "Kanalizimi i një pjese të Hanit të Elezit" kodi (83553) në shumën prej 5.000 €.

Nga projekti "Fond për trajnime të ndryshme" kodi (83405) shuma prej 1.500 € të ridestinohet në projektin "Kanalizimi i një pjese të Hanit të Elezit" kodi (83553) në shumën prej 1.500 €.

Nga projekti "Furnizim me transformator të rrymës elektrike në lagjen Kallamoqe" kodi (83406) shuma prej 2.000 € të ridestinohet në projektin "Kanalizimi i një pjese të Hanit të Elezit" kodi (83553) në shumën prej 2.000 €.



Nga projekti "Ndërtimi i objektit të Qendrës për Punë Sociale" kodit (83400) shuma prej 4.000 € të ridestinohet në projektin "Dislokimi i trafos së qytetit" kodit (83552) në shumën prej 4.000 €.

Nga projekti "Rregullimi i kanalizimit nga Uji i Thartë - Hani i Elezit" kodit (83404) shuma prej 9.000 € të ridestinohet në projektin "Adoptimi i zyrave për regjistrim të gjendjes civile" – projekt i ri në shumën prej 9.000 €.

Nga projekti "Punimi i nxehjes së shkollës fillore "Kështjella e Diturisë" në Paldenicë" kodit (83389) shuma prej 8.000 € të ridestinohet në projektin "Kanalizimi nga fshati Meliq -lagja e re" – projekt i ri në shumën prej 8.000 €.

Nga projekti "Rregullimi i Tensionit të lartë të rrymës nga rruga e Gorancës deri te ish Repetitori i TVP-se" kodit (83392) shuma prej 2.000 € të ridestinohet në projektin "Kanalizimi nga fshati Meliq - lagja e re" – projekt i ri në shumën prej 2.000 €.

Nga projekti "Rregullimi i rrugicës nga Lagja Ballazh – Meliq" kodit (83395) shuma prej 9.000 € të ridestinohet në projektin "Blerja e një kamioni për bartje të mbeturinave" në shumën prej 9.000€. Nga projekti "Vendosja e policëve të shtrirë nëpër rrugët kryesore të Hanit të Elezit" kodit (83397) shuma prej 2.102 € të ridestinohet në projektin "Blerja e një kamioni për bartje të mbeturinave".

Nga programi Planifikim urban dhe mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480) projekti "Rregullimi i rrugës dhe kanalizimi nga rruga e te Përndjekurve - Ura e Fezës" kodit (83407) shuma prej 6.680 € të transferohet në projektin "Riparimi i nyjeve sanitare nëpër shkolla" – projekt i ri në shumën prej 6.680 € në programin Arsimit dhe shkenca (920), nën-programi (92175) Administrata e arsimit .

**Ridestnimi i projekteve kapitale brenda programit Planifikim urban dhe mjedisi (660), nën programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480) nga të hyrat vetanake fondi 22**

Nga projekti "Rregullimi i rrugës prej lagjes së Krasniqëve deri te shkolla fillore "Kështjella e Diturisë" kodit (83551) shuma prej 6,174.90€ të ridestinohet në projektin "Adoptimi i zyrave për regjistrim të gjendjes civile" – projekt i ri në shumën prej 6,174.90€.

Nga projekti "Fond për shpronësim" kodit (81430) shuma prej 10.000€ të ridestinohet në projektin "Mirëmbajtja dhe sanimi i rrugëve" – projekt i ri në shumën prej 10.000€.

#### IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit.

#### V

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit  
Data: 25.08.2011

Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlasi

